




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI PËR INFORMIMIN

**MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 165 Prot, Datë 3. 2.2022



MINISTRIA E BRENDSHME

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHTETIT**

Nr. 908 Prot, Datë 3. 2.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

**GARANTIMIN E REALIZIMIT TË NJË PROCESI TË RREGULLT LIGJOR
TË IDENTIFIKIMIT DHE RIKUPERIMIT TË TRUPAVE TË ATYRE QË U
ZHDUKËN OSE U EKZEKUTUAN GJATË PERIUDHËS SË KOMUNIZMIT**

Nisur nga respektimi i të drejtës për dinjitet, të drejtës për jetën, të drejtës së familjarëve për të njohur të vërtetën mbi fatin e të afërmeve të tyre, të drejtës procedurale për një hetim efektiv, detyrimi për të respektuar mbetjet njerëzore (eshtrat e njeriut), e drejta për të respektuar kujtimin e një të afërmi të ndjerë (e drejta e memories);

Me synim bashkëpunimin ndërinstitucional për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit;

Në mbështetje të Ligjit nr.7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr.7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", ligjit 108/2014, "Për Policinë e Shtetit" i ndryshuar, ligjit 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe

Enteve Publike”, si dhe Konventës së OKB-së për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë, ratifikuar me ligjin Nr.9802, datë 13.02.2007, Ligjit nr.83/2018 ”Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) si dhe çdo akti tjetër ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon fushën e veprimit të kësaj marrëveshjeje;

Duke marrë parasysh, që krimi i zhdukjes me forcë është krim kundër njerëzimit, që shkel një sërë të drejtash të njeriut dhe shkakton viktima të shumëfishta, jo vetëm personat e zhdukur, por edhe familjarët e tyre apo persona të tjerë që kanë vuajtur drejtpërdrejt pasojat e krimit;

Duke nënvizuar, që e drejta e familjarëve për të ditur mbi fatin e të afërmeve të tyre është një e drejtë absolute, që nuk i nënshtrohet kufizimeve, që zhdukja me forcë është një krim që nuk parashkruhet, por zgjat derisa të përcaktohet fati dhe vendndodhja e viktimës, si dhe;

Duke njohur detyrimin dhe përgjegjësinë e shtetit për ta hetuar atë në mënyrë të efektshme, në zbatim të legjislacionit vendas dhe akteve ndërkombëtare të ratifikuara më ligj:

Marrëveshja e Bashkëpunimit lidhet ndërmjet:

Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me adresë: Njësia Administrative Nr.4, Rruga e ”Dibrës”, Garnizoni ”Skënderbej”, Tiranë (më poshtë referuar si ”Autoriteti”), përfaqësuar nga Kryetarja e Autoritetit, Kryetarja zj.Gentiana SULA,

dhe

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me adresë: Bulevardi ”Bajram Curri” (më poshtë referuar si ”Policia e Shtetit”), Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor, z.Gledis NANO,

që këtu e më poshtë do t’i referohemi si ”Palë”, bien dakord për marrëveshjen e bashkëpunimit, si më poshtë :

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkërendimi i veprimtarisë së dy institucioneve dhe forcimi i bashkëpunimit për të garantuar realizimin e një procesi të rregullt ligjor të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose ekzekutuan gjatë periudhës së komunizmit.

Neni 2

Detyrime të përbashkëta

1. Palët në marrëveshje bien dakord:

- Të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën dhe aktivitetet e tyre për përmbushjen e objektit të kësaj marrëveshjeje.
- Të bashkëpunojnë jo vetëm në nivel qendror mes tyre, por edhe në nivelin vendor të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe mes tyre dhe Autoritetit.
- Të shkëmbejnë rregullisht informacionet e nevojshme mbi ecurinë e punës për çështjet e personave të humbur në ndjekje e sipër prej tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe sekret hetimor,
- Të organizojnë takime të përbashkëta periodike për bashkërendimin dhe koordinimin e punës.
- Të mbështesin përmbushjen e objektit të kësaj marrëveshjeje me burime njerëzore dhe materiale të poseduara nga ana e tyre.
- Të zbatojnë parimet e përgjithshme të ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe ruajtjes së privatësisë në trajtimin e rasteve.
- Që veprimet dhe ndjekja e rasteve nga ana e tyre do jetë e shpejtë dhe transparente, duke mbajtur të informuar dhe përfshirë në proces familjarët e personave të humbur, në masën që është e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e tyre legjitime dhe për sa është e lejuar me ligj.

2. Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje nuk do të interpretohet si heqje dorë apo shmangie nga detyrat e veta funksionale të përcaktuara me ligj nga asnjëra palë nënshkruese e kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Detyrimet e Autoritetit

1. Autoriteti angazhohet:

- a) për mbledhjen e dëshmime gojore të familjarëve të personave të zhdukur, si dhe krijimin e një arkivi/databaze me këto dëshmi.
- b) për referimin e rasteve të personave të zhdukur në Policinë e Shtetit, për të cilat ka dijeni për vendndodhjen e eshtrave të tyre, nëpërmjet dëshmime gojore apo të shkruara që ai mbledh dhe për të cilët ka filluar procesi i gjetjes, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave.

- c) të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit/ Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit për përmbushjen e qëllimit të kësaj marrëveshjeje, me vënien në dispozicion të hetimit informacionin, i cili gjendet në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit apo dëshmi gojore të shkruara apo regjistruara të familjarëve apo të afërmeve të personave të zhdukur, si dhe çdo informacion tjetër, që posedon të marrë nga komunikimi me palë të treta, nëse ato mund të ndihmojnë në hetimin penal të rastit.

Neni 4

Detyrimet e Policisë së Shtetit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit angazhohet në nxjerrjen e aktit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për normimin e veprimtarisë së drejtorive vendore të saj, për hetimin me efikasitet të rasteve të personave të humbur dhe/ose zhdukur gjatë komunizmit, duke parashikuar në të:

- Inicimin e procedimit penal për çdo njoftim/referim/kallëzim nga ana e familjarëve apo të afërmeve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, ose grupeve të interesit apo institucioneve shtetërore, duke drejtuar dhe kryer hetimet e nevojshme për mbledhjen e provave, kryerjen e veprimeve të mëtejshme në vendin e ngjarjes, marrjen e dokumenteve arkivore dhe çdo gjë tjetër që i shërben procesit penal, për rastet që përbëjnë vepër penale të "zhdukjes me forcë".
- Inicimin kryesisht (ex officio) të veprimeve të para procedurale, edhe në rastet kur është vënë në dijeni për "person të zhdukur" gjatë komunizmit nga ndonjë palë tjetër, apo informacionit të mbledhur nga specialisti i policimit në komunitet.
- bashkëpunimin në nivel vendor të strukturave të Policisë së Shtetit mes tyre dhe Autoritetit, për qëllime të zbatimit të objektit të marrëveshjes.

2. Hartimi dhe miratimi i këtij akti, do të bëhet brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje.

Neni 5

Takime të përbashkëta

1. Çdo 6 (gjashtë) muaj titullarët e dy institucioneve, do të takohen së bashku për të diskutuar ecurinë e kësaj marrëveshjeje.

2. Takimet do të zhvillohen në kuadër të diskutimit për çështje me interes të përbashkët të palëve në këtë marrëveshje.

Neni 6

Personat e kontaktit

1. Palët për zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni.
3. Objekti i shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre do të jetë sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje.
4. Personat e kontaktit informojnë në vazhdimësi drejtuesit e institucioneve (në rastin e Autoritetit informohet organi kolegjal), mbi zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 7

Administrimi i informacionit

1. Bashkëpunimi midis palëve, shkëmbimi i informacionit, administrimi i informacionit gjatë realizimit të kësaj marrëveshje bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet normative të cilat normojnë veprimtarinë e secilës prej palëve të kësaj marrëveshje.
2. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, palët do të zbatojnë legjislacionin në fuqi.
3. Komunikimi ndërmjet pikave të kontaktit dhe përdorimi i mjeteve të komunikimit kryhet në përputhje me rregullat ligjore në fuqi të cilat normojnë informacionin e klasifikuar dhe informacionin në kuadër të procesit hetimor.

Neni 8

Dispozitat e fundit

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
2. Amendimet mund të bëhen me marrëveshje nga palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
3. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, që ka për objekt detyrimet e palëve, të bëhet me mirëkuptim.

4. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në secilën Palë të përfshirë në këtë Marrëveshje.

Kjo marrëveshje u nënshkrua në Tiranë, sot, më datë __/__/2022.

PËR

**AUTORITETIN PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Gentiana Sula
Gentiana SULA
KRËJTOARJA



PËR

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË POLICISË SË SHTETIT**

Drejtues Madhor Gledis NANO
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

